



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:072089

Datë: 23.02.2019

Numri i dokumentit: 00231726

P.nr.02/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN, gjyqtari **Sulltan Dobraj**, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër te pandehurës L. J. për shkak te veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.6 te KPRK-së, duke vendosur lidhur me akuzën e PTH-se nga Peja **PP/II.nr.2209/2018 te dt. 26.12.2018**, ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me dt.**31.01,2019**, me pjesëmarrjen e Prokurorit te shtetit Lumturije Vuçetaj, dhe te pandehurës, me dt.31.01.2019 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më dt.11.02.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E pandehura **L. J.**, e lindur me dt....,ku dhe tani banon, e bija e H. dhe nënës F. e vajzërisë G., me numër personal, posedon nr.telefoni ..., shqiptare, shtetase i Kosovës, gjendet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Për shkak se :

Më dt.22.10.2018 rreth orës 16:15 minuta pikërisht të udhëkryqi, nga pakujdesia ka shkel nenin 120 te ligjit për rregullat e trafikut rrugor, ne atë mënyrë që përderisa e pandehura po qarkullonte me veturën e saj te tipit VW Golf, me targa, kur arrin ne vendin e lartcekur duke mos ju përshtat shpejtësisë dhe distancës në mes te veturave, me pjesën e parme te veturës, e godet nga pas veturën e tipit VW Golf me targa ..., i cili ishte ne kolonë, e te cilin e drejtonte B.H., ku nga goditja vetura VW Golf përplaset me veturën e tipit Daimler Chycler, me targa të cilën e drejtonte V. T. , ku me pas vetura Daimler përplaset me veturën e tipit Daimler Chycler me targa ...të cilën e drejtonte SH.L., e si pasojë e aksidentit përveç dëmeve materiale, sipas ekspertizës mjeko ligjore te punuar për rastin, lëndime te lehta trupore pësojnë F.J., D.J., P.J. si dhe vetë e pandehura.

- **me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 1 lidhur me par. 6 te KPRK- së.**

Andaj gjykata, ne bazë te nenit 17, 41 ,45, 78, nenit 378 par. 1 lidhur me par 6 te KPRK-ës, nenit 365, 453, 463 par 2 te KPPRK-ës, të akuzuarin e:

E SHPALL FAJTORE DHE E LIRON NGA DËNIMI

- I. E pandehura **lirohet nga dënimi** për shkak se pasojat e veprës penale e kanë goditur te pandehurën aq rënde sa qe dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit te tij.
- II. Te dëmtuarit D.J., F.J. dhe P.J., udhëzohen ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.
- III. E pandehura obligohe që gjykatës ti paguan ne emër te shpenzimeve te procedurës penale shumen prej 125 (njëqind e njëzet e pesë) euro dhe 30 (tridhjetë) euro ne emër të fondit për kompensimin e viktimave te krimit.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën PP/II.nr.2209/2018 te dt. 26,12,2018 ka akuzuar të pandehurën L. J., për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1. lidhur me par.6të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet shqyrtimi gjyqësor kundër të njëjtës, të administrohen provat e duhura e me në fund e njëjta te shpallet fajtores dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe te ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt.31,01,2019 ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit te aktakuzës e pandehura e ka pranuar fajësinë, te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit fillestar ne bazë te nenit 248 te KPPK-ës.

Prokurori i shtetit ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse e pandehura e pranoi fajësinë e ky pranim i fajësisë mbështetet ne provat materiale te cilat gjenden e shkresat e lendes unë në tersi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj gjykatës i propozoi qe e njëjta te shpallet fajtores dhe te dënohet sipas ligjit, lidhur me vendimin për dënim si rrethana lehtësuese te merr pranimin e fajësisë, sjelljet e mira gjatë shqyrtimit, dhe faktin se është hera e parë qe ka renë ndesh me ligjin dhe faktin se e pandehura ju ka shkaktuar lëndime te lehta trupore familjareve te saj qe do te thotë se pasoja e ka goditur me shumë se një dënim i mundshëm.

E pandehura ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se shpreh keqardhje, jam e penduar, dhe nuk do ta përsëris këtë vepër , për mua me e rende ka qenë lëndimi qe ju kam shkaktuar nënës, vëllait dhe kushërirës time se sa një dënim i mundshëm i gjykatës.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Me dt.22.10.2018 rreth orës 16:15 minuta pikërisht të udhëkryqi, nga pakujdesia ka shkel nenin 120 te ligjit për rregullat e trafikut rrugor, ne atë mënyrë që përderisa e pandehura po qarkullonte me veturën e saj te tipit VW Golf, me targa ..., kur arrin ne vendin e lartcekur duke mos ju përshtat shpejtësisë dhe distancës në mes te veturave, me pjesën e parme te veturës, e godet nga pas veturën e tipit VW Golf me targa ..., i cili ishte ne kolonë, e te cilin e drejtonte B.H., ku nga goditja vetura VW Golf përplaset me veturën e tipit Daimler Chycler, me targa ... të cilën e drejtonte V.T., ku me pas vetura Daimler perplaset me veturën e tipit Daimler Chycler me targa të cilën e drejtonte SH.L., e si pasojë e aksidentit përveç dëmeve materiale, sipas ekspertizës mjeko ligjore te punuar për rastin, lëndime te lehta trupore pësojnë F.J., D.J., P.J.. Gjykata paraprakisht te pandehurës i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë e njëjta do të shpallet fajtoresh për veprën penale të lartcekur, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do te këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë e pandehura e cila i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo lajthim e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barre, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, ne materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Po ashtu gjykata duke u kujdesur zyrtarisht ne bazë te nenit 257 te KPPRK-ës nuk ka gjetur ndonjë prove te pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se e pandehura e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë në bazë te nenit 248 te KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bere ne mënyre vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te pandehurës janë formuar te gjitha elementet e figurës se veprës penal rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.1 lidhur me par.8 te KPRK-ës, ka konstatuar se e pandehura është përgjegjëse për këtë vepër penale, i ka kuptuar veprimet e saj por nuk e ka dashur pasojën e shkaktuar, ka vendosur dhe te pandehurën e ka shpall fajtoresh për këtë vepër penale, dhe e ka liruar nga dënimi.

Në bazë te nenit 78 paragraf 1 nen paragraf 1.1 te KPK, ku parashihen bazat e posaçme të lirimit nga dënimi për vepra penale të kryera nga pakujdesia, të pandehurën e ka shpallur fajtoresh për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni

378 paragraf 1 lidhur me paragraf 8 te KPK-ës dhe të njëjtën e ka liruar nga dënimi sepse në rastin konkret e pandehura pa dashje dhe nga pakujdesia e ka humbur kontrollin mbi automjetin e saj duke i aksidentuar anëtarët e familjes së tij ku ju ka shkaktuar lëndime të lehta trupore nënës së saj, vëllait të saj dhe kushërirës së saj, çka do të thotë ju ka shkaktuar lëndime të lehta trupore familjarëve të saj, andaj gjykata ka konsideruar se pasojat e veprës penale e kanë goditur të pandehurën aq rëndë sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij.

Gjykata në bazë të nenit 463 te KPPK-ës, të dëmtuarit D.J., F.J. dhe P.J, i udhëzon ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike sepse në shkresat e lëndës gjykata nuk ka gjetur një kërkesë pasurore juridike të specifikuar.

Gjykata në bazë të nenit 453 të KPPK-ës e ka obliguar të pandehurën që gjykatës të paguaj shpenzimet e procedurës penale ne shumë prej 125 euro, duke llogaritur shpenzimet për ekspertizën e komunikacionit ne shumë prej 50 euro, shpenzimet e ekspertizës mjeko ligjore ne shumë prej 20 euro dhe paushallin gjyqësorë ne shumë prej 55 euro, si dhe shumën prej 30 euro në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit. Qo do të thotë gjithsejte shumë prej 155 euro.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.02/2019 me dt. 11.02.2019**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e pranimi të kopjes së këtij aktgjykimi, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes Gjykatës Themelore Pejë dega ne Deçan.